



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



AKT NORMATIV

Nr. 1, datë 10.1.2021

PËR

MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES, PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V., DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, DHE MINISTRIT TË SHËNDETIT PËR RINDËRTIMIN, AUTORIZIMIN E PROCEDURËS PËR LEJIMIN E HYRJES DHE ADMINISTRIMIT TË VAKSINAVE ANTI-COVID-19 NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË SI DHE PËRDORIMIN E TYRE NË POPULLATË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i tekstit të marrëveshjes

Miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

ministrin të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

Aprovimi i përdorimit të vaksinës në popullatë

Vaksinat anti-covid-19 aprovohen për përdorimin në popullatë bazuar në aprovimin e *Food and Drugs Administration* të Shteteve të Bashkuara (FDA) të Amerikës dhe/ose *European Medicine Agency* (EMA) të Bashkimit Evropian.

Neni 3

Detyrimet e organeve shtetërore

1. Autorizohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Instituti i Shëndetit Publik të nënshkruajnë marrëveshjen për blerjen e vaksinës anti-Covid19 (*Pfizer-BioNTech Covid-19 Vaccine*) me *Pfizer B.V.*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.
2. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të lëshojë menjëherë lejen e importit për vaksinat anti-covid-19, si për sasinë dhe llojin e përcaktuar në këtë marrëveshje ashtu dhe për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, sipas kushteve dhe dokumentacionit të prodhuesit, duke përjashtuar produktin nga detyrimi për t'u shkruar paketimi në gjuhën shqipe dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga legjislacioni për barnat.
3. Autorizohet Instituti i Shëndetit Publik të administrojë procesin e transportit, të ruajtjes, të magazinimit, të shpërndarjes, të përdorimit në popullatë të vaksinës anti-Covid-19 dhe fushatën e vaksinimit, si për sasinë dhe llojin e përcaktuar në këtë marrëveshje ashtu dhe për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, sipas kushteve të përcaktuara nga prodhuesi, duke lidhur kontrata direkte me kontraktorët për mallra, punë dhe/ose shërbime për plotësimin e këtyre detyrimeve.
4. Autorizohet Instituti i Shëndetit Publik të kryejë parapagimet e dozave të vaksinave dhe pagesat respektive, sipas kushteve të cituara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve.

5. Policia e Shtetit të marrë masa për të garantuar sigurinë gjatë transportit dhe sigurinë e ambienteve ku do të ruhet dhe administrohet vaksina anti-Covid-19.

Neni 4

Përfshirja nga detyrimet

1. Të gjitha procedurat për mallra punë dhe/ose shërbime, si transporti, magazinimi, ruajtja, shpërndarja, përdorimi në popullatë i vaksinës anti-covid-19 dhe fushata e vaksinimit, si për sasi dhe llojin, të përcaktuara në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ, apo për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, përfshihen nga parashikimet e legjislacionit aktual për prokurimet publike si dhe çdo akti nënligjor, që kërkon miratim të posaçëm të kontratës së nënshkruar.
2. Të gjitha transaksionet që lidhën me përfitimin e vaksinës anti-Covid-19, të përcaktuara në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ, apo për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, si dhe palët respektive, përfshihen nga të gjitha detyrimet fiskale.
3. Marrëveshja për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *Pfizer Export B.V* nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në “Fletoren zyrtare”.
4. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

Neni 5

Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 115/1
DATË 12.1. 2021

KUVENDIT
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

A blue circular official stamp is positioned behind the signature. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRISË" at the top and "MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.